



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:197833

Datë: 28.04.2021

Numri i dokumentit: 01741858

P.nr. 800/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurve A. R. dhe R. R. për shkak te veprës penale ***lëndim i lehtë trupor***, parashikuar nga neni 185 par. 1 nen par. 1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore -Departamenti i përgjithshëm ne Pejë, PP/II nr.1905/19 të datës 09.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.13.04.2021, në prezencë të Prokurorit së shtetit Suada Hamza dhe te pandehurve A. R. dhe R. R. , dhe dëshmitari H. R., me dt. 13.04.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.26.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Te pandehurit

A. R. i lindur më, në fsh. K-, ku edhe banon rr.”.....” , i biri i Z. dhe nënës Z. e gjinisë K., i pamartuar, kate kryer shkollën e mesme, bujk, i gjendjes se mesme ekonomike, me numër personal, posedon nr. tel shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, mbrohet ne liri.

R. R. i lindur më, në fsh. K-, ku edhe banon, i biri i A. dhe nënës A. e gjinisë D., ka te kryer shkollën e fillore dhe dy vite të shkollës se mesme, me profesion bujk, i martuar, baba i pesë fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, me numër personal, posedon nr. tel shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, mbrohet ne liri.

JANË FAJTORË

I pandehuri A. R.

Për shkak se,

- Me datë 11.07.2019 rreth orës 21:00 minuta, ne fshatin K- i shkakton lëndim trupor te dëmtuarit R. R. , në atë mënyrë qe pas një zënke te çastit lidhur me një çështje pronësore ne momentin kur i pandehuri A. lëshon rreth 40 krerë lopë për te kullotur ne pronën e I. S. aty shkon i dëmtuari R. dhe sipas kërkesës se pronarit te lartshënuar shkon ne atë prone për ti thënë A. ta largoje bagëtinë nga aty për çka i pandehuri fillimisht i drejtohet me fjale “kaherë jam kat pres ty “, e pastaj fillon konflikti fizik mes tyre me ç ‘rast i pandehuri A. e godet te dëmtuarin ne krahun e djathte dhe ne qafe ku si pasoje e kësaj te njëjtit i shkakton lëndime te lehta trupore,

- me çka ka kryer vepër penale, ***lëndim i lehtë trupor***, parashikuar nga neni 185 par. 1 nen par. 1.4 të KPRK-së.

I pandehuri R. R.

Për shkak se,

- Me datë 11.07.2019 rreth orës 21:00 minuta, ne fshatin K- i shkakton lëndim trupor te dëmtuarit A. R., në atë mënyrë qe pas një zënke te çastit lidhur me një çështje pronësore ne momentin kur i dëmtuari A. lëshon rreth 40 krerë lopë për te kullotur ne pronën e I. S. i pandehuri R. shkon dhe i thotë qe ti largoje bagëtitë nga aty për çka i dëmtuari refuzon meqë kjo prone ende nuk është e definuar se kujt i takon për çka i dëmtuari refuzon meqë kjo prone ende nuk është definuar se kujt i takon për çka i pandehuri R. nga distanca e gjuan me gurë dhe e godet te dëmtuarin A. me gishtin e këmbës se djathte dhe pastaj gjate konfliktit fizik mes tyre i njëjti pëson lëndime edhe ne gishtin e pare të dorës së djathtë ku si pasoje e kësaj te njëjtit i shkakton lëndime te lehta trupore,

- me çka ka kryer vepër penale, ***lëndim i lehtë trupor***, parashikuar nga neni 185 par. 1 nen par. 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 38,39, 40, 43, 69, 70, nenit 185 par. 1 nen par.1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Të pandehurin A. R.

- Me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilin dënim obligohet që ta paguaj me se largu ne afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

- Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Të pandehurin R. R.

- Me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilin dënim obligohet që ta paguaj me se largu ne afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.
- Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.
- Të pandehurit obligohen që secili veç e veç në pagimin e paushallit gjyqësor ne shumen prej 30 (tridhjetë) €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Të pandehurit obligohen që secili veç e veç në pagimin e taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II nr.1905/19 të datës 09.09.2019, kundër të pandehurve A. R. dhe R. R. për shkak te veprës penale ***lëndim i lehtë trupor***, parashikuar nga neni 185 par. 1 nen par. 1.4 të KPRK-së.

Gjykata me dt. dt.13.04.2021, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në prezencë të Prokurorit së shtetit Suada Hamza dhe te pandehurve A. R. dhe R. R. , dhe dëshmitari H. R..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që të pandehurit u njoftua me pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, dhe pasi që të njëjtut u deklaruan se nuk ka nevojë për sqarime shtesë, të njëjtëve iu është dhënë mundësia të deklarohen sërish për pranimin apo mos pranimin e fajësisë, të pandehurit u deklarua se nuk e pranojnë fajësinë për veprën e cila i vihet në barë.

Pasi që të pandehuri nuk e pranuan fajësinë gjykata shqyrtimin gjyqësor e vazhdoj me procedurën e të provuarit, fillimisht me fjalët hyrëse të palëve, pastaj me administrimin e provave personale me dëgjimin dëshmitarit H. R., më pas me administrimin e provave formale-materiale dhe me ato formale materiale të propozuara nga organi i akuzës filluar nga: Akt ekspertimin mjeko-ligjor me nr. te Ref 14/2019 i dt 30.08.2019 i punuar nga Dr. F. D., Raporti i policit A. V. #9765 i dt. 12.07.2019; Deklarata e te dyshuarit R. R. e dhënë ne stacionin policor ne Peje me dt. 12.07.2019; deklarata e dëshmitarit H. R. e dhënë ne stacionin policor ne Peje me dt. 16.07.2019; intervista e te dyshuarit A. R. e dhënë ne stacionin policor ne Peje me dt.12.07.2019; fotoalbumi i shkresave te lëndës, Raporti i spitalit te përgjithshëm ne Peje nen nr. protokollit 12843 te dt. 12.07.2019 për te pandehurin A. R., Raporti i spitalit te përgjithshëm ne Peje, emergjenca, nen nr. protokollit 12834 i dt. 12.07.2019 si dhe fletë kontrolli mjekësor i dt. 12.07.2019 për te pandehurin R. R., Vërtetimi mbi sekuestrimin e

përkohshëm te sendeve, një sopat me dt. 12.07.2019 nga policia, prone e A. R., si dhe shkresat e tjera te lendes, si dhe është dëgjuar mbrojtja e të pandehurit.

Dëshmitari H. R. gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se: te pandehurit i njeh te dy, A. e ka djalin e vëllait ndërsa R., gjyshërit i kanë pasur vëllezër. Raportet me dy te pandehurit nuk i ka as te mira e as jo te mira Kohëve et fundit me R. nuk kane folur. Lidhur me rastin e dt. 11.07.2019 dëshmitari deklaroi se ka dhënë edhe një here deklaratë ne polici. Ai deklaroi se kur ka shkuar aty, A. ka qenë në livadh me lopët e tija, nuk ka vonuar shumë, ku R. ka qenë aty me dhentë e tija i cili shtëpinë nga livadhi e ka për afërsisht 500 metra dhe i njëjti ka qene duke i mjelur dhentë ne shtëpinë e tij. Pas bisedës ne mes te pandehurve dëshmitari thotë se i është detyruar me ndërhy mes tyre me fjale, për tu munduar ti afroje mes vete ashtu siç edhe u mundua edhe ne seance qe t’iu shpjegojnë mundësinë qe kjo çështje te shkoje ne procedure te ndërmjetësimit, ku menjëherë kane eksploduar me fjale ofenduese dhe gjuajtje me gurë, dëshmitari ka qene ne rrugë- asfalt dhe livadhi është skaj rrugës, dhe dëshmitari derisa te pandehurit tere kohen kane pasur mosmarrëveshje ne mes vete dhe janë gjuajtur me gurë dhe me drurë dëshmitari iu ka qëndru gjate gjithë kohës ne mes. Deri te përleshja ka ardh për shkak se atë toke , prone diku 40 vite e kane punuar dëshmitari (familjaret e A.) me marrëveshje te pronarit te tokës Sh. B. te cilin po ashtu e kane kushëri por me et largët. Sipas rregullave tona është adet qe nëse një toke e merr ne shfrytëzim për një vjet apo me shume, është rregull qe te pyetet personi qe e ka pas ne shfrytëzim a do ta vazhdoje mbajtjen ne shfrytëzim apo jo. Ne ndërkohe pas rastit te ndodhur ne e kemi kuptuar se edhe R. e kishte marr nga B. S. i cili ka pas pretendime blerje, thënë te vërtetën kjo toke dhe shtëpia e A. tani ndahet vetëm me një pale tela. Dëshmitari mohon faktin ti këtë thënë A. R. se “jam duke te prit ty”, i njëjti e mohon se te këtë dëgjuar një gjë te tille si dhe faktin se janë gjuajtur me gurë dhe me grushta, thekson se vetëm janë share ne mes vete, sepse dëshmitari thotë se ka qene ne afërsi te pandehurve rreth 2-3 metra dhe se here ka qëndrua përball A. e here përball R.it përleshje kjo e cila ka zgjatur rreth tre minutave. Pas përfundimit te përleshjes dëshmitari ka shkuar te shtëpia e A. dhe aty ai mi ka treguar këmbët dhe ai kishte lëndime ne këmbë dhe diku rreth gju, ne dore nuk i kujtohet sakte. Ndërsa dëshmitarit nuk i kujtohet se dy shenja nen gjunjë janë nga lëndimet qe i kishte pësuar A. , po ashtu nga fotoja fq.42 shihen lëndime ne dorën e djathte përballë, dëshmitari ka deklaruar se ka pasur lëndim edhe ne gishtin e madh te këmbës se djathte ndërsa deklaroi se sëpatën te paraqitur ne fotot e shkresave te lendes deklaroi se nuk e ka parë.

I pandehuri **A. R.** në mbrojtjen e tij ka deklaruar se me dt. 11.07.2019 rreth orës 21.00 ka qene ne fsh., dhe aty ka ardhur R. R. dhe i ka thënë ti largoj 40 krerë, e te cilën gjë i pandehuri A. e ka refuzuar. I pandehuri mohon faktin ti këtë thënë të pandehurit R. fjalët “kaherë jam duke te prit ty”. I pandehuri pohoi faktin se ne mes te pandehurve ka pasur konflikt fizik. Ndërsa lidhur me raportet te spitalit te përgjithshëm ne Peje, për R. ku konstatohet se ka pasur lëndime ne krah, mohon faktin se këto lëndime te ia këtë shkaktuar i pandehuri A. i cili thotë se këto lëndime, ka mundur me i pësuar këto lëndime ne mes te gardhit, gjate përleshjes. Beson qe nuk ja ka shkaktuar ai gjate përleshjes. I pandehuri ne mbrojtjen e tij deklaroi se nuk ka qene ne dijeni për faktin se i pandehuri R. e ka marr token e B. S. për shfrytëzim, atë parcele i kujtohet se e ka shfrytëzuar prej qe ka qene i vogël, bile aty thotë ka qene edhe një shtëpi, ku këta kane banuar aty. Tutje i pandehuri ka deklaruar se B. asnjëherë si ka thënë se token ia ka dhënë te pandehurit R. për shfrytëzimin e pronës pasi qe ka dëgjuar se është ndërruar pronari

dhe si duket B. S. do ta blejë, A. se bashku me vëllain e tij kanë pasur kontakt, duke i thonë se nëse e blen B. ai do të mundet ta marr me qira për shfrytëzim si ka bere edhe përpara. Marrëdhëniet ne mes të pandehurit A. dhe te pandehurit R. kane qene te mira deri atëherë kur i pandehuri **R. iu ka prerë pyllin dhe as qe e kane lajmëruar rastin ne polici**, dhe prej atëherë janë zbehur raportet mes tyre. Ne lidhje me sëpatën se e kujt është i pandehuri ka pranuar se sëpata është e tija dhe e ka përdor kur e ka qel shtegun për me i shti lopët e ka përdorur dhe prape e kam thur.

I pandehuri **R. R.** në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ditën kritike ka qene afër livadhit aty ka qene edhe i pandehuri A. te cilit i ka thënë ti largoj lopët dhe i ka tregu B. S. se dikush i ka shti ne livadh te tij lopët, aty ka qene prezentë edhe dëshmitari H.. I pandehuri mohon faktin te këtë share apo goditur te pandehurin A., deklaron se vetëm A. e ka share atë, dhe se mohon se ti këtë shkaktuar lëndime trupore te pandehurit A.. I pandehuri R. me tutje ka deklaruar se ka pasur marrëveshje gojore me B. S. dhe se te njëjtit ia ka paguar 200 euro për shfrytëzim te livadhit deri sa te bie bora, **po ashtu e pranon faktin se nuk është dashur te shkojnë livadh pasi qe se pari është dashur te dije se kush është tani ne shfrytëzim te livadhit** . I pandehuri thekson se te nesërmen e ka lajmëruar policin e po ashtu ka shku dhe e ka njoftu policinë për lëndime trupore dhe i njëjti iu ka treguar pir qe sipas te pandehurit policia nuk e kane fotografuar.

Prokurorja e shtetit Suada Hamza në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në kuptim te nenit 353 te KPPRK-së, paraqes fjalën përfundimtare, pas administrimit te provave dhe dëgjimit te serishëm te dëshmitarit, dëgjimit te deklaratave te pandehurve, është vërtetuar përtej dyshimit te bazuar mire se këtu dy te pandehurit kane kryer veprat penale te cilat i vihen ne barre sipas aktakuzës PP.II.1905/19. Provat me te cilat është vërtetuar gjendja faktike janë dëshmia e dëshmitarit H. R. i cili ne mënyrë te njëjtë si ne polici ashtu edhe sot ne shqyrtim gjyqësor përshkruan ngjarjen e ditës kritike ku theksi bie ne dëshminë e tij se dy te pandehurit për shkak te një mosmarrëveshje lidhur me pronën edhe ku ka ndodhur ngjarja te dy njeri tjetrin e kane gjuajtur me gurë dhe se nuk ka pasur aty ndonjë mjet tjetër saç pretendon këtu i pandehuri R. R. . Prove tjetër me te cilën vërtetohet gjendja faktike janë raportet mjekësore te lëshuara nga spitali emergjenca, ne Peje, ku tek te dy te pandehurit janë te evidentuara lëndimet. Prove tjetër edhe me bindëse se kjo është akt ekspertimi mjeko ligjor me nr. ref. 14/2019 te punuara nga eksperti i njohur i mjekësisë ligjore dr. F. D. ku mendimet përfundimtare tregojnë se dy te pandehurit kane pësuar lëndime te lehta trupore me lëndim te përkohshëm për shëndet. Prove tjetër e cila vërteton përtej dyshimit te bazuar mire gjendjen faktike te përshkruar ne aktakuze është edhe vet deklarata e këtu te pandehurit A. R. i cili pranon qe ditën kritike ne momentin kur ne vendin kritik ka ardh R. dhe i ka thënë te largohet nga aty me gjithë bagëtinë pas përleshjes verbale ata dy janë gjuajtur me gurë duke i shkaktuar lëndime njeri tjetrit, pra konsideroj qe ne njëfarë mënyrë i njëjti e pranon fajësinë deri sa i pandehuri R. R. edhe pse nuk e pranon fajësinë konsideroj qe ka prova te mjaftueshme te cilat vërtetojnë qe edhe ky i ka shkaktuar lëndime te lehta trupore A. R. ashtu siç janë te përshkruara ne akt ekspertimin e mjekut ligjor. Unë ia fal besimin deklaratave te A. R. dhe dëshmitarit H. R., ndërkaq i propozon gjykatës qe mos ti falet besimi deklaratës se R. R. ngase e njëjta është ne

kundërshtim me provat materiale ne shkresat e lendes. Propozon gjykatës qe te dy ti shpalle fajtor dhe ti dënojë sipas ligjit për veprat qe iu vihen ne barre.

I pandehuri A. R. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i vie keq qe i ka ndodhur ky rast, kërkon nga gjykata qe mundësisht te me shpalle një dënim sa me te lehte, i premtion gjykatës qe me nuk do përsëris vepra te tilla.

I pandehuri R. R. ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se edhe i rrahur, edhe i share, i maltretuar e edhe moralisht familjen ia ka shkatërruar edhe fizikisht e tani sipas fjalës se prokurores fajtor, konsideron qe është e padrejte, kërkon nga gjykata qe te me shpalle te pafajshëm dhe fjalën e prokurores nuk e pranon.

Gjendja e faktike e vërtetuar

Gjykata pas administrimit të provave, i ka vlerësuar të njëjtat veç e veç dhe në lidhmëni reciproke me njëra tjetrën dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiva të këtij aktgjykimi, ndaj të pandehurve A. R. dhe R. R. , gjykata këtë gjendje faktike vërtetoi nga provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqësor dhe atë nga deklarata e dëshmitarit H. R., nga akt ekspertimi mjeko ligjor me nr. ref. 14/2019 te punuara nga eksperti i njohur i mjekësisë ligjore dr. F. D. ku mendimet përfundimtare tregojnë se dy te pandehurit kane pësuar lëndime te lehta trupore me lëndim te përkohshëm për shëndet. Prove tjetër e cila vërteton se te pandehurit se pari kane pasur mosmarrëveshje e cila me vone është ka eskalu me bërtima e të shara si dhe me gjuajtje gurësh ne mes veti ashtu edhe siç është përshkruar edhe vet nga deklarata e te pandehurit A. R. i cili e pranon se ditën kritike ne momentin kur ne vendin kritik ka ardh R. dhe i ka thënë te largohet nga aty me gjithë bagëtinë pas përleshjes verbale ata dy janë gjuajtur me gurë duke i shkaktuar lëndime njeri tjetrit, e qe nga kjo konstatohet se i njëjti e pranon edhe fajësinë. Ndërsa sa i përket pandehurit R. R. deklarimet e tija kane qene kundërthënëse dhe ne kundërshtim me provat materiale të lendes respektivisht ne kundërshtim me akt ekspertimin e mjekut ligjor ku janë te përshkruara lëndimet trupore të shkaktuara nga i pandehuri R. te pandehurit A..

Pra nga të gjeturat me lartë gjykata vërtetoi faktin se në veprimet e të pandehurve A. R. dhe R. R. , qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale ***lëndim i lehtë trupor***, parashikuar nga neni 185 par. 1 e nen par. 1.4 të KPRK-së.

Sipas provave të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fotove te bashkangjitura si dhe nga deklarata dëshmitarit H. R. e dhënë në këtë shqyrtim kryesor – gjyqësor u vërtetua fakti se i njëjti se bashku me te dy te pandehurit ditën kritike kanë qenë afër livadhit te B. S. ku A. ka qene duke i kullotur 40 krerë lopë dhe aty ka ardhur i pandehuri R. i cili i ka thënë te pandehurit A. qe ti heq krerët e lopëve nga livadhi dhe fillimisht nga fjalosja kane filluar të shahen ne mes veti dhe te gjuhen me gurë ne mes veti.

Gjykata e ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të pandehurit A. R. i cili e mohon veprën penale, dhe e mohon faktin se i njëjti i ka shkaktuar lëndime trupore te pandehurit R., por i njëjti e ka

pranuar faktin se ditën kritike ka ardh R. dhe i ka thënë te largohet nga aty me gjithë bagëtinë pas përlëshjes verbale ata dy janë gjuajtur me gurë duke i shkaktuar lëndime njeri tjetrit, pra bazuar në këtë mbrojtja e tij është në kundërshtim me këtë deklaram sepse ne njëfarë mënyrë i njëjti e pranon fajësinë deri sa i pandehuri R. R. .

Ndërsa i pandehuri R. R. mbrojtjen e tij e mohon faktin te këtë share apo goditur te pandehurin A., duke deklaruar se me A. vetëm e ka share atë, dhe se mohon se ti këtë shkaktuar lëndime trupore te pandehurit A.. I pandehuri tere kohen pretendon se ai është i dëmtuar nga i pandehuri A. dhe se i njëjti i ka shkaktuar lëndime trupore. I pandehuri pafajësinë e tij e mbështeste ne atë se ka qene ne shfrytëzim te livadhit te B. S. për një kohe te caktuar, edhe pse ne kohen kur ky ka shkuar tek i pandehuri A. për ti thënë për ti larguar bagëtinë e drejta e shfrytëzimit ka qene e te pandehurit A. e për te cilën gjë edhe vet i pandehuri R. e pranon duke **thënë se nuk ditën kritike nuk është dashur te shkoj tek livadhi ku ka qene i pandehuri A..**

Gjykata këto pretendime të deklaruara nga te dy te pandehurit i vlerësoj si jo bindëse pasi që në këtë drejtim te pandehurit nuk i kane ofruar gjykatës asnjë provë për të provuar pafajësinë e tyre, për me shumë deklarimet e tyre janë në shperputhje me njëra tjetrën me argumentime te pa qëndrueshme, me pas në shperputhje me deklaramin e dëshmitarit H. R. dhe ne kundërshtim me provat tjera formale materiale përmes të secilave pasqyrohet nja gjendje krejt ndryshe, ku shihen lëndimet e pasqyruara për të pandehurin A. dhe për te pandehurin R., lëndime këto qe shihen ne fotot e shkresave të lëndës përmes fotove dhe sipas ekspertizave mjeko-ligjore. Mu për këtë gjykata mbrojtjen e te pandehurve e vlerësoi si jo bindëse dhe te orientuar me qëllim të ikjes apo zvogëlimit te përgjegjësia penale.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurve A. R. dhe R. R. ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale **lëndim i lehtë trupor**, parashikuar nga neni 185 par. 1 nen par. 1.4 të KPRK-së, dhe se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtonin përgjegjësia penale të pandehurve andaj te njëjtit janë penalisht përgjegjës, andaj të pandehurit i shpall fajtor si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar faktin se të pandehuri kanë pasur sjellje korrekte para gjykatës, faktin se me pare nuk kanë qene të dënuar dhe ndaj tyre nuk udhëhiqet ndonjë procedure tjetër penale. Ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurve gjykata nuk gjeti.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurit A. R. dhe R. R. i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësia penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë siç është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi zevendësimin e dënimit me gjobë ne dënim me burgim ndaj të pandehurve, gjykata, e mori në përputhje me nenin 43 par.3 të KPRK-ës, nëse te pandehurit refuzoin apo dështoin se paguari gjobat prej 400 euro, në afatin e përcaktuar pasi qe aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 dhe 2.7 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 25 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 3 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit i udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,
-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.800/19 më datë 26.04.2021**

**Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta**

**GJYQTARI
Dr. Sc. Murat Hulaj**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.